

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8322
E enjte, 18 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Pesë kandidatë kabjnë në fazën e radhës për kryeprokuror të shtetit

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PA SHUMICË TË QARTË, KOSOVA PËRBALLET ME SFIDËN E FORMIMIT TË INSTITUCIONEVE

FAQE 4-5



Njohësit e proceseve politike vlerësojnë se zgjedhjet e fundit nuk prodhuan një shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë

të institucioneve. Sipas tyre, votuesit nuk i kanë dhënë asnjë subjekt politik mundësinë që t'i formojë i vetëm institucionet.

Sipas përditësimit të fundit të KQZ-së, LV-ja ka siguruar 53 mandate, PDK-ja 22, LDK-ja 18, ndër- sa AAK-ja 7 mandate



PE MIRATON REZOLUTËN PËR KOSOVËN: REFORMAT DHE PËRPARIMI NË DIALOG, KYÇ PËR RRUGËN EVROPIANE

F. 5

SHBA-ja PARALAJMËRON 'PËRSHTATJE TË KONTRIBUTIT' NË KFOR

F. 3




OPINION

PAFYTYRËSIA, ANTIKOMBËTARIZMI DHE OPOZITA F. 5

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SHBA - IRAN DO TË MBAHET NË NJË RESORT MALOR NË ZVICËR F. 2


INAUGUROHET MURALI "ÇAST", NDEROHEN VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE GJATË LUFTËS F. 7

EKONOMI



REFUZIMI I GAZIT RREZIKON PARTNERITETIN E KOSOVËS ME SHBA-NË, PARALAJMËRON ODA AMERIKANE F. 8

SPORT



SPARTA KËRKON 10 MILIONË EURO PËR RRAHMANIN F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SHBA - IRAN DO TË MBAHET NË NJË RESORT MALOR NË ZVICËR

WASHINGTON, 17 QERSHOR - Zvicra njoftoi se ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, që synon dhënien fund të konfliktit në Lindjen e Mesme, do të mbahet në resortin malor të Burgenstokut.

Ministria e Jashtme zvicerane tha se ka qenë në kontakt të ngushtë me ShBA-në, Iranin, Pakistanin dhe Katarin lidhur me mundësinë e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Uashingtonit dhe Teheranit. Aktualisht, nënshkrimi i dokumentit është planifikuar për të premten, më 19 qershor, në Burgenstok, që ndodhet në kantonin e Nidvaldenit. Ky lokacion është propozuar nga ndërmjetësuesit pakistanezë dhe ata nga Katarin, si dhe nga Shtetet e Bashkuara dhe Irani, u tha në njoftim.

Burgenstoku është një kompleks i njohur rezidencial dhe për konferenca në Zvicrën qendrore, i cili më parë ka qenë mikpritës i takimeve

ndërkombëtare dhe negociatave diplomatike. Irani dhe Shtetet e Bashkuara e nënshkruan në mënyrë elektronike më 15 qershor memorandumun e mirëkuptimit për t'i dhënë fund luftës, i hartuar në formën e një dokumenti të përgjithshëm. Nënshkrimi zyrtar i dokumentit është planifikuar të bëhet më 19 qershor në praninë e zyrtarëve të lartë të të dyja vendeve.

Ndaras më 16 qershor, udhëheqësi amerikan Donald Trump, tha se do ta dërgojë marrëveshjen e paqes me Iranin në Kongresin Amerikan për shqyrtim.

Duke folur për gazetaret gjatë një takimi me presidentin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Mohammed bin Zayed Al Nahyan, në margjinat e samitit të G7 në Francë, Trumpi tha: "Nuk e kam menduar më parë, por do ta bëj... do t'ia dërgoj Kongresit. Më pëlqen ideja. Kush nuk do ta miratonte?".

Disa ligjvënës republikanë më herët kishin bërë thirrje që



kongresistët ta shqyrtonin tekstin e marrëveshjes.

Trumpi, po ashtu, premtoi se do ta bëjë publik tekstin e marrëveshjes me Iranin "brenda një ose dy ditësh" dhe sugjeroi se mund ta lexojë të gjithë dokumentin publikisht sapo të vendoset një kornizë zyrtare për publikimin e tij.

Sipas "Reuters"-it, ai tha se po priste një procedurë zyrtare para publikimit, por shtoi se nuk kishte kundërshtim që ai të bëhej publik. "Do të doja të kishte më parë një kornizë zyrtare për këtë, por nuk kam problem me publikimin, është

një dokument i shkëlqyer", tha Trumpi.

Ai shtoi se dispozita kryesore e marrëveshjes është e thjeshtë: "Irani nuk do të ketë kurrë armë bërthamore".

Sa i përket fazës së ardhshme të negociatave me Iranin, për të cilën është vendosur një afat 60-ditor, Trumpi shprehu optimizëm se përparimi do të jetë i shpejtë. "Mendoj se do të shkojë shumë shpejt", tha ai duke shtuar se Irani dëshiron ta finalizojë procesin dhe të kthehet në aktivitet normal ekonomik dhe diplomatik. "Irani dëshiron ta përfundojë këtë. Ata

duhet t'u kthehen aktiviteteve të tyre normale dhe marrëdhëniet tani janë normalizuar, kështu që mendoj se ky proces do të ecë shumë shpejt".

Trumpi paralajmëroi se afati kohor mund të ndryshojë, por përsëriti pritjet e tij për një përfundim të shpejtë: "Mund të shkojë më shpejt, mund të zgjasë më shumë, por mund të përfundojë shumë shpejt".

Nënpresidenti amerikan, JD Vance, ka deklaruar më herët se dokumenti - që palët nënshkruan në mënyrë elektronike - është rreth një faqe e gjysmë i gjatë.

Lufta nisi pasi ShBA-ja dhe Izraeli kryen sulme ajrore ndaj Iranit në fund të shkurtit. Teherani u kundërpërgjigj me sulme ndaj aseteve amerikane në rajon dhe që nga nisja e konfliktit praktikisht ka mbyllur Ngushticën e Hormuzit. Marrëveshja parasheh edhe rihapjen e ngushticës përmes së cilës kalon një e pesta e dërgesave globale të naftës dhe gazit.

CISTERNAT E PARA ME NAFTË IRANIANE LARGOHEN NGA NGUSHTICA E HORMUZIT

TEHRAN, 17 QERSHOR - Cisterna që transportojnë naftë të papërpunuar iraniane janë larguar nga Ngushtica e Hormuzit për herë të parë që kur Shtetet e Bashkuara nisën bllokadën detare dy muaj më parë, tha më 17 qershor një uebfaqe që gjurmon lëvizjet e anijeve.

Ky zhvillim vjen teksa përfaqësuesit e lartë të Iranit dhe ShBA-së pritet të nënshkruajnë një marrëveshje fillestare në Zvicër më 19 qershor, që synon përfundimin e luftës që nisi në fund të shkurtit.

Uebfaqja Tanker Trackers, që

gjurmon ruajtjen dhe transportimin e naftës, konfirmoi lëvizjen e "eksportit të parë të naftës së papërpunuar të Iranit në dy muaj", bazuar në të dhënat digjitale që tha se përkonin me imazhet satelitore.

Të paktën dy anije cisternë të Kompanisë Kombëtare Iraniane të Cisternave, përfshirë edhe dy super-cisterna me naftë të papërpunuar të quajtura "Diona" dhe "Hero2" që kanë kaluar përmes zonës të bllokadës të marinës detare amerikane, janë ngarkuar me 3.8 milionë fuçi naftë të papërpunuar iraniane



nga terminalët e shtetit dhe më pas kanë lëvizur drejt destinacioneve të tyre", shkroi në X ueb-faqja Tanker Trackers.

Më pas, kompania njoftoi se edhe

një cisternë e tretë iraniane kishte kaluar përmes bllokadës detare të ShBA-së.

Irani dhe Shtetet e Bashkuara e nënshkruan në mënyrë

elektronike më 15 qershor memorandumun e mirëkuptimit për t'i dhënë fund luftës, i hartuar në formën e një dokumenti të përgjithshëm.

Përveç përfundimit të luftës, ky memorandum kishte në fokus edhe rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, trugë kyçe ujore nga e cila rëndom kalon një e pesta e dërgesave globale të naftës dhe gazit.

Pas nënshkrimit të memorandumit më 19 qershor, është paraparë që palët të kenë një afat 60-ditor për fazën e ardhshme të negociatave.

SHBA-ja NDALON IMPORTIN E DËRGESAVE TË KOMPANISË KINEZE NË SERBI

WASHINGTON, 17 QERSHOR - Agjencia Amerikane për Doganat dhe Mbrojtjen e Kufirit (CBP) njoftoi të martën se ka lëshuar një urdhër për ndalimin e dërgesave të bakrit dhe produkteve të bakrit që prodhohen në Serbi nga kompania kineze Zijin Copper D.O.O. për shkak të dyshimeve se në procesin e prodhimit është përdorur puna me detyrim.

Vendimi hyn menjëherë në fuqi dhe personeli i CBP-së në të gjitha pikat hyrëse në Shtetet e Bashkuara do t'i ndalojë dërgesat e produkteve të bakrit të prodhuara në objektet e Zijin-it në Serbi, u tha në njoftim.

Ky është urdhri i dytë që CBP-ja

lëshon për ndalimin e dërgesave të kompanive kineze që operojnë në Serbi për shkak të përdorimit të punës me detyrim, pasi një urdhër i ngjashëm ishte lëshuar më parë për gomat e automjeteve që kompania Linglong prodhon në Zrenjanin, në veri të Serbisë. "Prodhuesit amerikanë përballen me konkurrencë të pandershme kur kompanitë e huaja i ulin kostot duke përdorur punë me detyrim", deklaroi

ndihmëskomisionerja ekzekutive e Zyrës për Tregti të CBP-së, Susan S. Thomas. "Duke zbatuar ligjet tona kundër punës me detyrim, CBP-ja mbron të drejtat e njeriut si dhe sigurinë

ekonomike të vendit tonë", shtoi ajo.

Sipas njoftimit, urdhri për ndalimin e dërgesave të Zijin-it është rezultat i një hetimi të CBP-së dhe informacioneve që tregojnë se Zijin Serbia prodhon bakër dhe produkte bakri duke përdorur punë me detyrim.

Në njoftim thuhet, po ashtu, se CBP-ja ka analizuar deklaratatë të punëtorëve, fotografi, shënime nga terreni të grupeve të fokusit, mesazheve tekstuale, raporte të organizatave joqeveritare që janë të qasshme për publikun, artikuj medialë dhe kërkime akademike. "Kur u morën së bashku, këto prova treguan se punëtorët në kompaninë Zijin Serbia janë të



eksponuar ndaj gjashtë treguesve të punës me detyrim të përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës: shfrytëzimit të cenueshmërisë, mosdhënies së pagave, frikësimit dhe kërcënimeve, kufizimit të lirisë së lëvizjes, mbajtjes së dokumenteve personale dhe orëve të tepërta të punës jashtë orarit", thuhet në njoftim.

CBP-ja theksoi se faktet që

mbështesin këta tregues dëshmojnë se punëtorët janë përfshirë në punë me detyrim, pra në punë që kryhet jovullnetarisht dhe nën kërcënimin e ndëshkimit.

Duke theksuar se të dhënat tregtare tregojnë që produktet e Zijin-it importohen ose ka gjasë të importohen në Shtetet e Bashkuara, CBP-ja njoftoi se importuesit e dërgesave të ndaluara mund t'i shkatërojnë ose t'i rieksporitojnë ato, ose mund të përipiqen të dëshmojnë se mallrat nuk janë prodhuar duke përdorur me detyrim.

Kompania kineze Zijin është përballur më parë me akuza për ndotje të mjedisit.

SHBA-ja PARALAJMËRON 'PËRSHTATJE TË KONTRIBUTIT' NË KFOR

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara pritet të bëjnë ndryshime në kontributin e tyre në misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR, në kuadër të një procesi më të gjerë të rishikimit të pranisë ushtarake të Aleancës në vend.

Një zyrtar i Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM) tha për Radion Evropa e Lirë se vendimi bazohet në rishikimin vjetor të bërë nga Komanda Supreme e Forcave Aleate në Evropë (SHAPE), e cila rekomandoi përshtatjen e trupave në terren. "Bazuar në rishikimin më të fundit vjetor të Komandës Supreme të Forcave Aleate në Evropë, NATO-ja do të optimizojë pozicionimin e Forcës së Kosovës (KFOR). Si rezultat, Komanda Evropiane e SHBA-së do të bëjë një përshtatje - në faza dhe të bazuar në vlerësim të rrezikut - të kontributit amerikan në KFOR, në përputhje me këtë rishikim të udhëhequr nga SHAPE", tha zyrtari i EUCOM-it për Radion Evropa e Lirë.

Ai shtoi se ShBA-ja vazhdon ta konsiderojë misionin një komponent kyç të stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor, pa dhënë hollësi për natyrën apo përmasën e ndryshimeve të mundshme.

NATO: Prani më e vogël graduale në KFOR

Javën e kaluar NATO-ja njoftoi se do ta zvogëlojë gradualisht praninë në Kosovë gjatë vitit të ardhshëm, për shkak të, siç tha, përmirësimit të situatës së sigurisë.

Radio Evropa e Lirë kërkoi sqarime nga selia e Aleancës në Bruksel për treguesit konkretë që mbështesin këtë vlerësim, veçanërisht në veri të Kosovës, ku situata mbetet e brishtë. Në përgjigje, një zyrtar i NATO-s tha se Aleanca nuk komenton çështje operative apo të inteligjencës, por theksoi se situata në terren monitorohet vazhdimisht dhe nga afër përmes mjeteve të ndryshme, për të siguruar që misioni mbetet i përshtatshëm për qëllimin e tij.

Aktualisht KFOR-i përbëhet nga mbi 4 600 trupa nga 31 vende.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi edhe ministritë e Mbrojtjes në Itali dhe Hungari - dy nga kontribuueset kryesore në KFOR, krahas ShBA-së - për të mësuar nëse planifikojnë rishikim të forcave të tyre, por nuk mori përgjigje.

As Ministria e Mbrojtjes e Kosovës nuk iu përgjigj kërkesës për koment.

Në një aktivitet javën e kaluar, kryeministri në detyrë i Kosovës,



Albin Kurti, deklaroi se Kosova ka ushtri të fortë dhe polici të aftë dhe se, së shpejti, do të ketë edhe xhandarmëri, me synim garantimin e paqes, stabilitetit dhe avancimin drejt integritetit në NATO dhe BE.

KFOR-i mbetet reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës si reagues i parë dhe misionit të BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, si reagues i dytë. Misioni është përgjegjës për sigurinë përgjatë kufirit me Serbinë, ndërsa në pjesët e tjera të vijës kufitare përgjegjësinë e ka Policia e Kosovës.

Debati për praninë amerikane në Kosovë dhe më gjerë

Në Kosovë Shtetet e Bashkuara kanë aktualisht rreth 590 ushtarë të dislokuar në kuadër të KFOR-it - një ulje e ndjeshme krahasuar me mbi 5 000 trupat e vendosura në vitin 1999, kur misioni u krijua pas përfundimit të luftës. Që nga ajo kohë, ShBA-ja ka edhe kampin Bondsteel pranë Ferizajt, që konsiderohet baza më e madhe ushtarake amerikane në Ballkan.

Debati për rishikimin e mundshëm të pranisë amerikane në Kosovë nisi qysh në fillim të vitit të kaluar, kur sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, paralajmëroi se Evropa duhet të përgatitet për një rishikim dhe reduktim eventual të pranisë ushtarake amerikane.

Gjatë një vizite në Varshavë atëkohë, Hegseth tha se e ardhmja e pranisë amerikane do të varet nga kërcënimet globale dhe prioritetet strategjike të ShBA-së.

Megjithatë, një zyrtar i Departamentit Amerikan të Mbrojtjes tha për Radion Evropa e Lirë asokohe se nuk ka ndryshime në pozicionimin aktual të forcave amerikane.

Po në shkurt të këtij viti, gazeta amerikane "Politico", duke cituar katër diplomatë të NATO-s, raportoi se ShBA-ja është duke kërkuar nga Aleanca ta shkurtojë aktivitetin e jashtëm, përfshirë misionin paqeruajtës në Kosovë - KFOR.

Edhe atëherë, një zyrtar i Pentagonit konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se nuk ka ndryshime në dislokimin e forcave amerikane.

Sipas Komandës Evropiane të ShBA-së, numri i përgjithshëm i forcave amerikane në Evropë është luhatur mes 75 000 dhe 105 000 që nga viti 2022. Prej tyre, rreth 63 000 janë të dislokuara në mënyrë të përhershme, ndërsa pjesa tjetër shërben me rotacion.

Numri më i madh i trupave amerikane - mbi 35 000 - ndodhet në Gjermani, ku gjendet edhe baza ajrore Ramstein, me mbi 16 000 ushtarakë, civilë dhe kontraktorë.

Në fillim të majit, ShBA-ja njoftoi tërheqjen e 5 000 trupave nga Gjermania brenda 6-12 muajve të ardhshëm.

Zëdhënësi i Pentagonit, Sean Parnell, tha se vendimi pasqyron nevojat operacionale dhe situatën në terren.

"Reduktimi i ShBA-së në KFOR do të ishte destabilizues"

Një raport i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar

në fund të muajit të kaluar, e përshkroi praninë e ShBA-së në KFOR si komponent kyç për garantimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë.

Analisti Mark Montgomery, nga Fondacioni për Mbrojtjen e Demokracive, thotë për Radion Evropa e Lirë se çdo reduktim i pranisë amerikane në KFOR do të ishte "shumë destabilizues", pasi do ta largonte ShBA-në nga "pika më e mundshme e tensioneve" - kufiri Kosovë-Serbi - dhe do të dërgonte sinjal se Uashingtoni po tërhiqet nga roli i sigurisë.

Ai shton se ShBA-ja është thelbësore për suksesin e KFOR-it dhe se diskutimet për ndryshime në politikën ndaj Kosovës janë "shqetësuese", pasi mund ta dobësojnë parandalimin dhe ta nxisin Serbinë ta testojë vendosmërinë e ShBA-së dhe të Evropës.

Montgomery thekson se ruajtja e niveleve aktuale të trupave amerikane në KFOR është një masë me kosto të ulët, por me rëndësi të lartë strategjike, ndërsa çdo zvogëlim do të sillte, sipas tij, "kohë më të vështira" për Kosovën dhe rajonin. "Pa asnjë zëvendësim logjik për Shtetet e Bashkuara në këtë rast, ka shumë gjasa që kushtet të destabilizohen më tej nëse ShBA-ja bën një hap prapa", thotë Montgomery.

Ai shton se Kosova duhet ta forcojë partneritetin me Shtetet e Bashkuara duke thelluar bashkëpunimin ekonomik, duke avancuar pavarësinë energjetike dhe duke lobuar vazhdimisht për një rol të qëndrueshëm dhe të fuqishëm amerikan në KFOR. Në të njëjtën kohë, ai thekson se vendi duhet ta zgjidhë edhe bllokadën e brendshme politike

dhe të dëshmojë stabilitet institucional dhe qeverisje demokratike.

Për Erin Bancin, eksperte e sigurisë në Institutin Atlas për Çështje Ndërkombëtare, reduktimi i paralajmëruar i trupave të NATO-s në Kosovë, veçanërisht i atyre amerikane, pasqyron një qasje më të gjerë të ShBA-së për ndarjen e barrës me aleatët dhe përqendrimin në prioritetet tjera strategjike, si Indo-Paqësori.

Edhe ajo vlerëson se tërheqja e tillë mund t'i rrisë rreziqet për destabilizim në një rajon ende të brishtë. "Çelësi do të jetë mënyra se si do të menaxhohet kjo tërheqje. Varet nëse do të jetë graduale, e koordinuar me aleatët dhe e shoqëruar me një angazhim të fortë diplomatik, apo nëse do të jetë një reduktim i nxituar dhe i keqkomunikuar, i cili rrezikon të krijojë një boshllëk sigurie, të cilin Rusia ose aktorë të tjerë të jashtëm mund ta shfrytëzojnë", thotë Banc për Radion Evropa e Lirë.

Sa trupa i ka NATO-ja në Kosovë?

Gjithsej 4 657 trupa nga 31 vende të botës shërbejnë aktualisht në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), KFOR. Gati gjysma e forcave janë nga Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Hungaria dhe Turqia.



PA SHUMICË TË QARTË, KOSOVA PËRBALLET ME SFIDËN E FORMIMIT TË INSTITUCIONEVE

Njohësit e proceseve politike vlerësojnë se zgjedhjet e fundit nuk prodhuan një shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve. Sipas tyre, votuesit nuk i kanë dhënë asnjë subjekti politik mundësinë që t'i formojë i vetëm institucionet. Sipas përditësimit të fundit të KQZ-së, LV-ja ka siguruar 53 mandate, PDK-ja 22, LDK-ja 18, ndërsa AAK-ja 7 mandate

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

Prishtinë, 17 qershor - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përditësuar rezultatet e partive politike të zgjedhjeve të 7 qershorit.

Lëvizja Vetëvendosje tashmë ka arritur në 53 ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës ka rënë në 18 sosh. Partia Demokratike ka ruajtur 22 ulëset të cilat i kishte më parë, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka 7 ulëse. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar procesi i numërimit të fletëvotimeve. Të mërkurën në mëngjes ka filluar numërimi i fletëvotimeve nga votimi me kusht, i cili është mundësuar në 52 vendvotime me kusht, ku janë evidentuar 8,751 votues. Po ashtu, ka filluar edhe numërimi i fletëvotimeve nga votimi i personave me nevoja të veçanta, i realizuar jashtë vendvotimeve, ku për këtë lloj votimi kanë qenë të regjistruar 3

144 votues.

Votimi përmes postës është mundësuar nga 21 maj deri më 6 qershor 2026, ndërsa numri i shtetasve të Kosovës të regjistruar për të votuar përmes postës ishte rreth 105 mijë. Të dielën (14 qershor) KQZ ka përmbyllur procesin e vlerësimit të 85 790 pako të supozuara me fletëvotime, prej të cilave janë aprovuar 82 809, ndërsa 2 981 refuzuar.

Votimi me kusht është zhvilluar të dielën, më 7 qershor, në 38 Qendra të Votimit, nga një për çdo komunë, me gjithsej 52 vendvotime.

Edhe votimi i personave me nevoja të veçanta është zhvilluar të dielën, më 7 qershor, por ky lloj votimi është mundësuar jashtë vendvotimeve, në adresa të caktuara të votuesve të regjistruar dhe të evidentuar për të votuar përmes ekipeve lëvizëse.

Me përfundimin e numërimit të votave nga diaspora dhe fillimin e trajtimit të votave me kusht dhe atyre të personave me nevoja të veçanta, procesi i numërimit të rezultateve zgjedhore po hyn në

fazën përmbyllëse.

Eugen Cakolli nga KDI-ja ka theksuar se situata përfundimtare me ndarjen e mandateve 53 - 22 - 18 - 7 tashmë është pothuajse çështje e kryer. "As kutitë e mbetura të votave me postë, e as 11 895 votat me kusht dhe votat e personave me nevoja të veçanta që do të numërohen nesër, nuk priten ta ndryshojnë ndarjen e mandateve - përveç nëse prodhojnë ndonjë devijim krejt të pazakontë nga trendet e deritanishme. Historikisht, votat me kusht kanë ndjekur më shumë trendin e vendvotimeve të rregullta, me dallime relativisht të vogla. Prandaj, përveç nëse rezultati i këtyre votave i afrohet dukshëm trendit të votave me postë, LV-ja nuk pritet të arrijë në 54 mandate", ka thënë ai.

Cakolli ka theksuar se, në anën tjetër, pas performancës dukshëm më të dobët në kutitë e fundit të votave me postë, LDK-ja e ka tejet të vështirë të rikthehet në 19 mandate, duke ia marrë një mandat PDK-së (mundësia e vetme). "Për këtë, LDK-ja jo vetëm që do të duhej ta kalonte

PDK-në në renditjen sipas votave me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta, por do të duhej ta bënte këtë me një dallim prej disa qindra votash", ka thënë Cakolli.

Gazetari Adriatik Kelmendi ka theksuar se votuesit në zgjedhjet e 7 qershorit nuk ia kanë deleguar asnjë subjekti politik të drejtën që t'i bëjë institucionet vetë. "LV-ja humb 4 deputetë, LDK-ja i shton 3, AAK-ja 1 deputet më tepër. Komunitetet joshumicë 20. Votuesi nuk ia ka deleguar asnjë subjekti politik të drejtën që t'i bëjë institucionet vetë", ka shkruar Kelmendi në "Facebook". Edhe njohësi i proceseve politike në vend, Ismet Kryeziu, ka thënë se fakti që zgjedhjet e fundit në Kosovë nuk prodhuan një shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve nuk duhet të interpretohet domosdoshmërisht si dëshmi e një kulture politike thellësisht pluraliste apo si refuzim qytetar ndaj tendencave për përqendrim të pushtetit. "Një rol të rëndësishëm luan edhe arkitektura kushtetuese dhe zgjedhore e vendit. Sistemi proporcional i përfaqësimit, i kombinuar me vendet e garantuara për komunitetet joshumicë, e bën shumë më të vështirë krijimin e shumicave të mëdha parlamentare që do t'i mundësonin një partie të vetme

kontroll të plotë mbi institucionet", ka thënë ai.

Kryeziu ka theksuar se tri palë zgjedhje brenda një periudhe relativisht të shkurtër kanë dëshmuar se vota, në vetvete, nuk është zgjidhje për çdo krizë politike. "Zgjedhjet mund të përcaktojnë fitues dhe humbës, por ato nuk mund të krijojnë vullnet politik aty ku ai mungon. Pa një përkushtim të sinqertë për funksionalitet institucional, kulturë kompromisi dhe respektim të rregullave demokratike, zgjedhjet rrezikojnë të shndërrohen në mekanizëm të përsëritjes së krizave, e jo të zgjidhjes së tyre. Kërkesa e një subjekti politik për të fituar mbi 60 për qind të votave, siç ishte rasti i LV-së, mund të jetë një synim legjitim elektoral. Çdo parti synon të sigurojë sa më shumë mbështetje. Megjithatë, kur shumica absolute paraqitet si kusht për formim të institucioneve ose si justifikim me arsyetimin se opozita është jobashkëpunuese, kjo shndërrohet më tepër në një përpjekje për përqendrim të pushtetit", është shprehur Kryeziu.

Ai ka shtuar se përvoja e shteteve të rajonit tregon se përqendrimi i pushtetit në duart e një force të vetme politike, edhe kur buron nga zgjedhje formalisht demokratike, mund

PE MIRATON REZOLUTËN PËR KOSOVËN: REFORMAT DHE PËRPARIMI NË DIALOG, KYÇ PËR RRUGËN EVROPIANE

Prishtinë, 17 qershor - Parlamenti Evropian ka miratuar një rezolutë për Kosovën ku thuhet se reformat dhe përparimi në dialogun Kosovë - Serbi mbeten kyç në rrugën evropiane të vendit.

Rezoluta u miratua me 412 vota për, 174 kundër dhe 58 abstenime. "Vazhdimi i reformave dhe përparimi në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mbeten kyç në rrugën evropiane", shkroi në X raportuesi për Kosovën në PE, Riho Terras, pas miratimit të rezolutës.

Në rezolutë përshëndetet përkushtimi i vazhdueshëm i Kosovës ndaj procesit integruar. Në këtë kontekst, aty thuhet se dialogu për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi, që ndërmjetësohet nga Brukseli, mbetet pjesë integrale e perspektivës evropiane të Kosovës. Kosova dhe Serbia nuk kanë zhvilluar dialog të nivelit të lartë që nga shtatori i vitit 2023, pak ditë para sulmit të armatosur në Banjaskë.

Zëvendëskryeministrit në detyrë, Glauk Konjufca, ka deklaruar në fillim të majit se nuk pret që gjatë këtij viti të ketë ndonjë zhvillim në dialog. "Të shohim në vitin 2027 sesi do të zhvillohen gjërat, por për shkak të zhvillimeve nuk pres diçka, as ndonjë iniciativë evropiane shumë të fokusuar në muajt e vitit që kanë mbetur", tha ai më 11 maj. Ai tha se problemi më i madh në dialog qëndron në "goditja në mirëbesim" që i është bërë procesit "nga ana e Serbisë". Konjufca tha se sulmi në Banjaskë më 2023 dhe ai në kanalën e Ibër-Lepencit më 2024 dëmtojnë mirëbesimin në procesin e normalizimit të raporteve, që ka nisur më 2011 dhe që

ndërmjetësohet nga BE-ja.

Në rezolutën e miratuar të PE-së është përsëritur qëndrimi se viti 2025 ishte vit i humbur për vendin, duke tërhequr vërejtjen se edhe muajt e vitit 2026 po rrezikohen humbje për shkak të krizës politike.

Në rezolutë thuhet se për shkak të situatës politike, Kosova mund të humbë mjete financiare nga Plani i Rritjes, pasi ekziston frika se Kosova nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë kriteret e nevojshme. Pakoja e BE-së për Ballkanin Perëndimor - për periudhën 2024-2027 - është në vlerë të 6 miliardë eurove. Nga kjo shumë Kosovës i takojnë rreth 882 milionë euro - 253 milionë si grante dhe 629 milionë euro në formë të kredisë - që do të thotë se vendi përfiton më së shumti fonde në rajon për kokë banori.

Fundi i qershorit të këtij viti është afati kur secili shtet i rajonit futet në të ashtuquajturin moment të humbjes së përhershme nëse nuk i përmbush reformat e dakorduara paraprakisht.

Më herët, burimet i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se nëse nuk ndërmerren të gjitha reformat, Kosova mund të humbasë 68.8 milionë euro.

Gjatë krizës politike vitin e kaluar në Kosovë - kur vendi mbajti dy palë zgjedhje parlamentare për shkak të pamundësisë së formimit të institucioneve - u vunë në dyshim fondet nga Plani i Rritjes, por edhe fonde nga mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Kosova mbajti më 7 qershor zgjedhje të parakohshme parlamentare për shkak se legjislatura e kaluar s'arriti ta zgjidhte presidentin e ri. Fituese e zgjedhjeve është Lëvizja



Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë Albin Kurti, parti e cila pritet të ketë 53 vende në Kuvendin prej 120 ulësesh.

Paraprakisht në fillim të qershorit, për këtë rezolutë - që ishte në formë raportit - ishte debatuar në Komitetin për Politikë të Jashtme të PE-së (AFET).

Në mbledhjen e 3 qershorit raportuesi për Kosovën në PE, Riho Terras, deklaroi se 18 muajt e fundit kanë qenë të vështirë për Kosovën. "Ngërçi politik ka një ndikim të rëndësishëm në të ardhmen e vendit. Është e rëndësishme që Kosova të qëndrojë në rrugën evropiane dhe të ecë përpara me integrimin", deklaroi ai.

Terras, po ashtu, tha se shpreson që pas zgjedhjeve të 7 qershorit, Kosova të dalë nga qorrrokaku politik.

Përmes rezolutës shprehet mbështetja e fuqishme për synimet e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian. Po ashtu, shprehet keqardhje për ngërçin politik dhe, siç u tha, polarizimin që po e shoqërojnë vendin si dhe për proceset e shumta zgjedhore të viteve të fundit.

Rezoluta ofron mbështetje edhe për aplikimin e Kosovës për

statusin e vendit kandidat dhe u bëhet thirrje shteteve anëtare që, pa vonesa të panevojshme, ta mandatojnë Komisionin Evropian për përpilimin e pyetësorit.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në fund të dhjetorit të vitit 2022, por aplikimi i Prishtinës ende nuk është shqyrtuar nga BE-ja.

Këshilli i Bashkimit Evropian, sipas rezolutës, ftohet të veprojë me shpejtësi dhe t'ia japë Kosovës statusin e kandidatit pasi të jenë përmbushur kriteret përkatëse. Po ashtu, u bëhet thirrje pesë shteteve mosnjohëse të BE-së - Rumanisë, Greqisë, Sllovakisë, Spanjës dhe Qipros - që ta njohin pavarësinë e Kosovës, në mënyrë që të mundësohet avancimi i barabartë i Kosovës me shtetet e tjera candidate.

Në këtë drejtim rikujtohet mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) më 2010, sipas të cilit, shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

Rezoluta, po ashtu, përshëndet vendimin, siç thuhet, "ndonëse të vonuar", për heqjen e masave ndëshkuese që BE-ja kishte vendosur ndaj Kosovës dhe

theksohet se ato kanë qenë në kundërshtim të qartë me angazhimin e dëshmuar të Kosovës ndaj vlerave evropiane dhe përafritimit me politikat e bllokut evropian. Aty thuhet se masat kanë qenë të pajustificuara dhe se ato kanë pasur ndikim negativ në shoqërinë e Kosovës.

Në rezolutë vihet në pikëpyetje mungesa e transparencës dhe e parashikueshmërisë, niveli i informimit publik, si dhe kohëzgjatja e zgjatuar e masave, pavarësisht prej faktit se Kosova i kishte përmbushur kërkesat për heqjen e tyre.

Kosovës dhe Serbisë, përmes rezolutës, u bëhet thirrje të bashkëpunojnë dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për t'i sjellë sa më shpejt para drejtësisë autorët e sulmit të vitit 2023 në Banjaskë.

Më 24 shtator 2023 një grup serbësh të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës në Banjaskë të Zveçanit, duke vrarë një rreshter. Gjatë këmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues serbë. Këtë sulm Kosova e konsideron terrorist dhe e fajëson Beogradin, por Serbia mohon përfshirjen.

Për sulmin në Banjaskë autoritetet në Kosovë kanë dënua tre të akuzuar, teksa dhjetëra të tjerë gjenden në arrati. Millan Radoičiq, ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit - ka marrë përgjegjësinë për organizimin e sulmit, teksa Kosova kërkon vazhdimisht që Serbia ta ekstradojë atë.

Në rezolutën e PE-së shprehet keqardhje për faktin se Serbia ende nuk i ka ndjekur penalisht përgjegjësit për këtë sulm, veçanërisht Radoičiqin.

Pesë kandidatë kalojnë në fazën e radhës për kryeprokuror të shtetit

Prishtinë, 17 qershor - Paneli Vlerësues i Këshillit Prokurorial të Kosovës për emërimin e kryeprokurorit të shtetit, i kryesuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Arian Gashi, së bashku me anëtarët Elza Bajrami - Kastrati dhe Visar Krasniqi ka mbajtur të mërkurën takim në kuadër të procedurës së përzgjedhjes së kryeprokurorit të shtetit.

Gjatë takimit paneli vlerësues ka shqyrtuar dhe vlerësuar dokumentacionin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë, me qëllim të



verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, paneli vlerësues ka konstatuar se të gjithë kandidatët që kanë aplikuar kanë plotësuar kushtet për të vazhduar në fazat e mëtejme të procesit të përzgjedhjes e të cilët janë: Atdhe Dema, prokuror në Prokurorinë Speciale të Kosovës; Naim Abazi, prokuror në Prokurorinë Speciale të Kosovës; Rafet Halimi, prokuror në Prokurorinë

Speciale të Kosovës; Shqipdon Fazliu, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; dhe Zejnullah Gashi, kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Procesi i vlerësimit është zhvilluar në mënyrë transparente dhe në përputhje me standardet e përcaktuara ligjore.

Paneli Vlerësues do të vazhdojë me procedurat e mëtejme të procesit të përzgjedhjes së kryeprokurorit të shtetit në përputhje me afatet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

të çojë drejt sistemeve hibride, ku zgjedhjet zhvillohen rregullisht, por kontrolli institucional, llogaridhënia dhe konkurrenca politike dobësohen gradualisht. "Përqendrimi i pushtetit është një fenomen që shfaqet në forma të ndryshme dhe që vazhdon të mbetet sfidë për

shumicën e vendeve të Ballkanit, edhe pas më shumë se 30 vitesh tranzicion demokratik. Ai nuk manifestohet përmes ndalimit të zgjedhjeve apo eliminimit formal të pluralizmit politik, por përmes dobësimit gradual të kushteve që e bëjnë demokracinë funksionale. Kur zgjedhjet dhe vota ndikohen

nga klientelizmi, nepotizmi, punësimet partiake, ndihmat sociale apo varësia ekonomike e qytetarëve nga pushteti, liria reale e zgjedhjes vihet në pikëpyetje. Në këto rrethana zgjedhjet vazhdojnë të mbahen, por ato nuk garantojnë domosdoshmërisht që qeveria të jetë shprehje e vullnetit të lirë

të qytetarëve. Demokracitë nuk rrënohen gjithmonë nga mungesa e zgjedhjeve, por shpesh nga tendenca për ta përqendruar pushtetin në emër të efikasitetit, stabilitetit apo vullnetit të shumicës. Po aq problematike për funksionimin demokratik mund të jetë edhe një kulturë politike ku opozita e

shihet bllokimi institucional si strategji të përhershme veprimi. Prandaj, ekzistenca e procesit zgjedhor dhe e shumë partive politike nuk mjafton për të dëshmuar se një vend gëzon demokraci të konsoliduar. Një demokraci e tillë shpesh mbetet vetëm një pluralizëm formal", ka deklaruar Kryeziu.

PAFYTYRËSIA, ANTIKOMBËTARIZMI DHE OPOZITA



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

1. Pafytyrësia: Askush, as në imagjinatën më të shëmtuar nuk ka besuar se 27 vite pas përfundimit të luftës, ata që lanë shekuj e shekuj nga jeta e tyre në kampet e përqendrimit të ish-Jugosllavisë, shëndetin e tyre dhe, në jo pak raste edhe jetën e tyre do të sulmohen aq poshtërsisht dhe brutalisht nga "njerëzit" që erdhën në pushtet me një program "puro kombëtar" sikur që ishte bashkimi kombëtar. Doli të jetë rrenë dhe mashtrim i madh. Askush nuk do të besonte se Frymëzimi dhe Kuptimi i luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, baca Adem Demaçi do të marginalizohet në atë masë nga sekt i pushtet sa që keqpërdoret vetëm kur kanë nevojë për vota sipas parimit: "e kalova lumin, ta q... kalin...". Askush, përveç trashëgimtarëve të mendësive jugosllave e serbe që kanë metastazuar në pushtetin aktual si kancer antikombëtar, nuk do të besonte se: "erdhi dita .." që çlirimtarët, invalidët e luftës çlirimtare, viktimat e luftës dhe ato civile do të trajtohen më keq se ushtri, policia dhe paramilitarët e Serbisë. Pushteti aktual e dëshmon përmes dejonave, hekurave, ardiave, agimbahtirave, dimalave, gjinovcave, vetonave, shkëlzenave, xhymshitave e horrave dhe horreshave, që janë shumicë absolute se antikombëtarizmi është biznesi më fitimprurës në Kosovë. Nuk mbeti askush pa u sulmuar nga horrat e sajber zagarëve të pushtetit dhe vet pushteti. As Pijemonti i shqiptarisë, Prekazi heroik, as Babai i mendimit dhe veprimt politik, Bacë Adem Demaçi, as familja Haradinaj që edhe me qelizën më të vogël luftuan dhe u vranë për lirinë, çlirim dhe bashkimin kombëtar. Dhe, që një mendje minimalisht normale nuk e kupton dhe nuk e pranon është fakti se në mënyrë të vazhdueshme brutalisht po sulmohet familja Jashari e cila po bënë përpjekje të ringritet mbi

themelet e ndërtuara me gjakun, jetët dhe luftën e 56 heronjve të kombit, me kryeherin legjendar, Komandantin Adem Jasharin. Shumë larg kanë shkuar horrat që nuk kishin guxim të luftonin kundër pushtuesve (kishin gjenetikë politike të përbashkët) ndërsa sot luftojnë varret, lapidarët, gjakun dhe kujtimet e atyre që rënë për liri. Pisa dhe të pafytyrë!

2. Antikombëtarët: Persona të afërt me pushtetin dhe vet pushteti, poshtërsisht dhe me mendësi serbe dhe greke janë sulur kundër çdo vlere kombëtare, në veçanti kundër familjeve Haradinaj dhe Jashari përkatësisht kundër Daut dhe Ramush Haradinaj, Murat dhe Rifat Jashari. Një psikopat e "denonconte" Sami Serbinë, një analfabet doktor shkence ua mbanë zhagun prokurorëve të kriminalizuar të Gjykatës Speciale Raciste në Hagë që kërkuan nga 45 vite burg për udhëheqësit ushtarakë dhe politikë të UÇK-së dhe institucioneve të Kosovës që e shpallën pavarësinë dhe e bënë Kosovën shtet, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Se poshtërsia shkon përtej çdo kufiri është heshtja e krerëve të pushtetit ndaj këtyre deklaratave antikombëtare të anëtarëve të tyre. Madje Shvarc Donika vetëm sa e përforcon këtë deklaratë, si antikombëtare që është dhe shpërdoruese e kombëtarizmit të trashëguar. Te rasti i Xhevroslavës nga Fushë Kosova që çaraveshej në një foto me Lenka Haxhiun, vetëm pas tre ditëve reagoi dega e sektit të LV-së me një reagim të qullët (shprehje e Kurthit). Ndërkaq, Lenka Haxhiu, si shpërdoruese brutale e kombëtarizmit të trashëguar nuk e tha edhe një fjalë të vetme. Hiç këtu një 10 përqindësh (maksimalisht) që nuk mendojnë si kamikazët dhe dhunuesit publik dhe virtual të çdo vlere kombëtare, të tjerët janë të ngjashëm, ashtu ligjërojnë, ashtu mendojnë ndërkaq këta i

përdorin si vuvuzela.

Albin Kurthi është padre padrino (koka e kokave) të këtyre sulmeve denigruese, pa asnjë dyshim. Po të mos ishte kështu kurrë nuk do të kishte asnjë sulm antikombëtar!

Dejona Mihali është madre madrino e çdo sulmi ndaj çdo vlere kombëtare, që nga ideja fillestare e deri te konkretizimi patologjik. Për lexuesin e nderuar, termet padre padrino dhe madre madrino janë emërtime dhe cilësime të Mafies. Sikur që është natyra dhe karakteri i tyre. "Primadona" e të gjitha të këqijave në Kosovë, madre madrino, Dejona Mihali është pa një të kaluar njerëzore, kombëtare dhe politike në Shqipëri, me një të tashme të kriminalizuar në Kosovë dhe, me gjasë nëse i shpëton ligjit në Kosovë, me një të ardhme në ndritur në Serbi dhe Greqi. Pa asnjë brengë materiale dhe pa asnjë ndjenjë të përgjegjësive morale. Falë Martin Strujës dhe Vuk Hamoviqit! Edhe një pordhë e Sami Lushtakut është më kontribuese se krejt "aktiviteti kombëtar" i kësaj Vejushë të Zezë. Ndërkaq, në planin e dhënies së kontributit për emancipim politik dhe kombëtar të shqiptarëve në Kosovë, Përparim Rama, si trashëgimtar i gjyshit Rrahim Rama, axhës Hajrush Rama dhe babait Kadrush Rama, për Dejonën është Akademi e Shkencave dhe e Arteve.

3. Opozita: Në zgjedhjet e fundit, përkundër blerjes së votave nga Kurthi dhe pisi Murati, i fituan 53 mandate brenda Kosovës ndërkaq opozita 47 mandate. Rrjeti mafioz i hajnave elektorale në ambasada, konsullata dhe përfaqësi tjera duke korruptuar votuesit i siguruan sektit të LV-së mbi 83 për qind ndërkaq në votimet me postë, gjithashtu duke vjedhur vota, mbi 70 për qind duke përmbysur rezultatin përmes korrupsionit dhe kimit elektorale. Duke iu siguruar 5 deputetë. Realisht, votat e jashtme dhunuan votat e

brendshme. Votat e atyre që jetojnë jashtë dhe që vijnë shumë rrallë ose hiç në Kosovë e devijuan rezultatin e zgjedhjeve. Votat e atyre që në diasporë pa asnjë turp dhe moral marrin shtesa për fëmijë ndonëse fëmijët jetojnë jashtë dhe shtesat i marrin në shtetin ku jetojnë, marrin para për tekste shkollore ndonëse fëmijët i shkollojnë në gjuhë të huaj, paturpësisht marrin shtesa sociale dhe pensione që nuk iu takojnë, marrin kompensim për bileta kur duhet të votojnë dhe për karton të gjelbër, këta janë votuesit e pamoralshëm të Albin "Babës", këta janë ata që nuk kanë dhënë asnjë kontribut për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, këta janë ndotësit e shëndetit social dhe moral në Kosovë dhe në diasporë, këta urrejnë patologjikisht UÇK-në, luftën çlirimtare, ish-të burgosurit politikë dhe çdo vlerë kombëtare. Këta që asgjë nuk bëjnë për Kosovën, që nuk përballen me asnjë pasojë si rezultat i një qeverisjeje dhe kriminale të pushtetit aktual, i dhunojnë dhe delegjtimojnë votat e qytetarëve të Kosovës që jetojnë në Kosovë dhe që përballen me 100 mijë probleme të regjimit diktatorial dhe antikombëtar të Albin Kurthit. Opozita ka bërë gabim të madh që ka marrë pjesë në zgjedhjet e fundit të blera me para sepse nuk ka pasur gjasa të fitojë. Kësh e ka lekun, e ha byrekun. Tash, opozita bën gabim vetëvrasës nëse në çfarëdo forme të mundshme lidhet me Kurthin dhe sektin e tij. Pse ta kushtëzojë opozita bashkëpunimin me Kurthin me pranimin e gazit amerikan kur vet Kurthi do ta bëjë këtë duke e pranuar projektin amerikan. Opozita nuk duhet ta pranojë asnjë kushtëzim të Kurthit pavarësisht kërcënimit me zgjedhje të reje. Zgjedhjet eventuale të reja do ta dëmtojnë Kurthin brenda duke e bërë të papërfillshëm votën nga diaspora. Opozita nuk duhet fare të merret me Kurthin por duhet të veprojë në mënyrë të organizuar dhe të

vendosur kundër qeverisjes së keqe dhe pasojave që e rëndojnë jetën e qytetarit. Opozita duhet të riorganizohet; LDK dhe PDK duhet të zgjedhin lidhësi tjetër. Habitem pse në PDK nuk ka reflektim të menjëhershëm për këtë rezultat zgjedhor. Nuk ka pse të priten zgjedhjet e brendshme, kryetari i PDK duhet të lëshojë rrugë. Edhe në LDK. Nëse bëhen këto ndryshime, opozita do të forcohet dukshëm. PDK nuk duhet të mbetet peng i Hagës, forcimi i partisë i ndihmon edhe çlirimtarët në Hagë. Këta janë hapat kirurgjikalë që mund ta ringjallin një opozitë të vdekur klinikisht. Kurrsesi oportunisti dhe përshtatja. Sot, sipas mendimit tim në tërë kampusin opozitar i vetmi është Përparim Rama që ka koçë politike. Prandaj po sulmohet aq shumë nga regjimi autokrat i Kurthit dhe nuk po mbrohet nga LDK ndonëse i fitoi dy mandate si kryetar i Prishtinës. Edhe me vota të PDK-së.

Duhet një përafrim dhe përbashkim i të gjitha forcave patriotike dhe politike që kanë kontribuar, sakrifikuar dhe vulosur në procesin e shtetformimit dhe shtetndërtimit. Opozita në asnjë rrethanë nuk duhet të bëhet pjesë e pushtetit por duhet ta bëjë masën kritike për një veprim jashtinstitucional, figurativisht duke e sjellë Zvërnecin në Kosovë. Pas përfundimit të luftës në Iran, mund të zgjidhet edhe lufta në Ukrainë. Pastaj në tavolinën e menysë vjen Kosova. Me një Rusi johumbëse, gjasat e Kosovës për një përfundim dhe marrëveshje fitimprurëse me Serbinë dukshëm zvogëlohen. Po vijnë ditë të vështira për Kosovën, si në planin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar. Pushteti aktual interesohet vetëm për pushtet, asgjë nuk mund të mbrojnë, as nuk dinë e as nuk dëgjojnë. Shiheni të kaluarën e tyre, falë shumë pak përjashtimeve, as personalisht e as familjarisht kurrë dhe asnjëherë nuk e kanë dhënë asnjë kontribut për Kombin dhe vendin. Përkundrazi!

KRYENEGOCIATORI ZULFAJ NË LUKSEMBURG: KOSOVA KA SHËNUAR PËRPARIM NË FUSHËN E SUNDIMIT TË LIGJIT

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Me ftesë nga kryesuesja e presidencës së BE-së - Qipro dhe Komisioni Evropian, kryenegociatori i Republikës së Kosovës me BE-në, Jeton Zulfaj, mori pjesë në takim të ministrave për Çështje Evropiane në kuadër të takimit të Këshillit të BE-së për Çështje të Përgjithshme (GAC), që u mbajt në Luksemburg. Ky ishte takimi i parë me përbërje nga shtetet partnere të zgjerimit në nismën "Mburoja e Demokracisë Evropiane" prej kur u iniciuar nga Komisioni Evropian në nëntor të 2025-s. Në fjalimin e tij, Zulfaj theksoi se demokracia është fusha e vetme ku integrimi në instrumentet e BE-së duhet të jetë i shpejtë dhe jo gradual. "Paqja, liria dhe prosperiteti i BE-së janë ndërtoar mbi

themelin demokratik", tha Zulfaj.

Ai vuri në dukje se demokracia nuk është e garantuar, por një trashëgimi që çdo brez duhet ta mbrojë.

Kryenegociatori Zulfaj ka pohuar se Kosova ka shënuar përparim të rëndësishëm demokratik, në fushën e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medieve dhe standardet zgjedhore. Megjithatë, ai shtoi se Kosova mbetet cak i ndërhyrjeve të huaja dhe fushatave dezinformuese, përfshirë

narrativat ruse që shpërndahen në rajon përmes Serbisë, me synim polarizimin shoqëror dhe minimin e zgjedhjes demokratike të qytetarëve. Ai kujtoi se në zgjedhjet e këtij viti u regjistruan dhjetëra



mijëra postime politike, video të gjeneruara me inteligjencë artificiale dhe deklarata të fabrikuara, ndërsa misioni i vëzhgimit të BE-së vitin e kaluar identifikoi dhjetëra artikuj nga mediet ruse "Sputnik Srbija" dhe "Russia

Today" me bazë në Beograd, që kanë targetuar fushatën zgjedhore të Kosovës me dezinformim.

Kryenegociatori Zulfaj potencoi se Kosova tashmë ka ndërmarrë hapa konkretë për forcimin e qëndrueshmërisë

digjitale dhe demokratike, përfshirë themelimin e Ministrisë së Digjitalizimit, zgjerimin e shërbimeve të eKosova, ngritjen e kapaciteteve të sigurisë kibernetike, si dhe investimin në edukimin medial dhe qytetarinë aktive.

Në këtë drejtim ai mirëpriti përfshirjen e vendeve partnere të zgjerimit në Mburojën e Demokracisë Evropiane dhe theksoi rëndësinë e përfshirjes së hershme në mekanizmat e kësaj iniciative duke përfshirë kanalet e paralajmërimit të hershëm, protokollat e reagimit ndaj incidenteve, ushtrimet e reagimit të shpejtë, si dhe lidhjen e fakt-kontrolluesve (fact-checkers) dhe studuesve nga Kosova me Observatorin Evropian të Medieve Digjitale (EDMO).

SHQIPËRI: SEKUESTROHEN 150 MILIONË EURO PASURI, DYSHOHET SE BURONIN NGA TRAFIKIMI I 50 TONË KOKAINË

TIRANË, 17 QERSHOR - Prokuroria e Posaçme në Shqipëri ka goditur një rrjet që trafikonte kokainë nga Amerika Latine drejt Shqipërisë dhe paratë e përfituara i investonte në ndërtim, hoteleri apo konsulencë.

Autoritetet thanë se kanë sekuestruar pasuri në vlerë prej rreth 150 milionë eurosh.

Tri ditë më parë Prokuroria e Posaçme goditi një tjetër rrjet të dyshuar ndërkombëtar të trafikut të kokainës dhe pastrimit të parave. Pjesë e hetimit për këtë grup janë edhe kontrata shitjeje toke në zonën e Zvërnecit afër Vlorës.

Të dy grupet, për të cilat vijojnë hetimet, dyshohet se trafikonin drogë nga Amerika Latine drejt Evropës dhe paratë i investonin kryesisht në ndërtim, në Tiranë dhe në bregdetin e jugut të Shqipërisë.

Pas kërkesës së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e njohur si SPAK, gjykata ka caktuar masën e sigurisë me burg për dhjetë persona, të akuzuar për trafikim të lëndëve narkotike, pastrim të produkteve të veprës penale



dhe grup i strukturuar kriminal. Nga të gjitha fletarrestimet, vetëm një prej tyre është ekzekutuar, për dy të tjerë vazhdon kërkimi, ndërsa shtatë personat e mbetur, sipas autoriteteve, nuk ndodhen në Shqipëri. Për arrestimin e tyre, SPAK-u është duke bashkëpunuar me agjencitë e zbatimit të ligjit të vendeve të tjera.

Sipas Prokurorisë së Posaçme gjatë viteve 2019-2021, ky grup ka vepruar në Amerikën Latine, Brazil, Belgjikë dhe Holandë.

Nga hetimet e kryera, dyshohet se personat ndaj të cilëve është zhvilluar hetim kanë trafikuar të paktën 50 tonë kokainë. Autoritetet thanë se janë

provuar pesë episode të trafikimit të kokainës nga Ekuadori dhe Kolumbia në Belgjikë dhe Holandë.

Nga hetimet, thanë autoritetet, është provuar se një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave të përfituara nga trafikim ndërkombëtar i kokainës janë transferuar në Shqipëri, në formën monetare kesh për ta shmangur sistemin bankar dhe më pas janë investuar në pasuri të paluajtshme, në krijimin dhe blerjen e aksioneve të kompanive tregtare, shoqëri të ndryshme kryesisht në fushën e ndërtimit, hotelierisë, konsulencës e të tjera. "Përmes këtyre investimeve dyshohet se është realizuar pastrimi i

produkteve të veprimtarisë kriminale, duke fshehur origjinën e tyre të paligjshme dhe duke mundësuar integrimin e tyre në ekonominë dhe qarkullimin financiar të ligjshëm", tha SPAK-u.

Prokuroria tha se pas injektiveve të parave kesh në llogaritë e një kompanie tregtare, me qëllim "justifikimin" e investimeve të ardhshme, në muajt maj-qershor 2021, rezultoi se kjo kompani ka filluar aktivitetin e saj në sektorin e ndërtimit. "Dyshohet se, për të mos tërhequr menjëherë vëmendjen nga strukturat ligjzbatuese, personi nën hetim I.A., orientoi që kompania të shfaqej fillimisht si nënkontraktore për ndërtim banesash. Shfaqja e kompanisë në këtë mënyrë do të 'justifikonte' sërish flukset e ardhshme të parave kesh dhe shtrirjen e pritshme në sektorin e ndërtimit", tha SPAK-u.

Sipas hetimeve paraprake, dyshohet se skema e pastrimit të parave është realizuar përmes blerjes fiktive të kuotave të kapitalit në shoqëri tregtare, me çmime shumëfish më të ulëta se vlera nominale, për ta marrë

kontrollin e kompanive me kosto minimale. Fondet janë qarkulluar përmes huave mes personave fizikë dhe kompanive të lidhura, me qëllim krijimin e një historiku ekonomik fiktiv dhe humbjen e gjurmës së origjinës së parave, përpara integrimin të tyre në ekonominë formale.

Gjykata ka vendosur nën sekuestro 491 pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në pronësi të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë të personave nën hetim. Bëhet fjalë për pasuri apo aksione të nëntë shoqërive tregtare. Autoritetet thanë se janë sekuestruar 266 pasuri të paluajtshme të llojeve tokë arë, tokë truall, hotel, poste parkimi dhe apartamente, me vendndodhje në Tiranë, Durrës, Elbasan, Hamallaj, Lezhë, Shkodër, Himarë, Sarandë. Gjithashtu janë sekuestruar 209 llogari bankare. Vlera e pasurive të sekuestruara është rreth 150 milionë euro, sipas SPAK-ut.

Ky aksion i SPAK-ut është kryer në bashkëpunim me Eurojust, Europol, autoritetet gjyqësore të Ekuadorit, Francës, Kolumbisë, Holandës, dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në Shqipëri.

Inaugurohet murali "Çast", nderohen viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Është inauguruar murali "Çast" i cili nderon viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ky mural u organizua nga fondacioni "Jahjaga" në bashkëpunim me komunën e Prishtinës. Kryetarja e këtij fondacioni,

Atifete Jahjaga, ka treguar se ky mural ka një rëndësi të veçantë, sepse është një akt i dinjitetit dhe kujtesës.

Edhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se ky mural, i vendosur në zemër të Prishtinës, është një akt kujtese dhe respekti për të gjithë të

mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. "Ky mural është në nderim të çdo gruaje dhe burri që mbijetoi këtë krim të tmerrshëm lufte. E përgëzoj presidenten Jahjaga për këtë iniciativë, kuratoren Eliza Hoxha, Q'art për realizimin. Jemi shumë i

lumtur që ne, si kryeqytet, kemi pasur mundësinë që, sadopak, ta mbështesim dhe t'i japim hapësirë kësaj pjese të historisë sonë të përbashkët. Ky mural do të mbetet këtu, që secili që kalon pranë tij ta kujtojë sakrificën e këtij populli", ka thënë kryetari Rama.



REFUZIMI I GAZIT RREZIKON PARTNERITETIN E KOSOVËS ME SHBA-NË, PARALAJMËRON ODA AMERIKANE

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shprehu shqetësim për "mungesën e vazhdueshme të konsideratës" nga Qeveria në detyrë e Kosovës karshi thirrjeve të qeverisë amerikane për përfshirjen e vendit në infrastrukturën dhe rrjetin e furnizimit me gaz të lëngshëm natyror (LNG), duke paralajmëruar se një shpërfillje e thirrjeve amerikane mund të ketë ndikim në partneritetin mes dy vendeve. "Oda Amerikane vlerëson se partneriteti strategjik i Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbetet një nga asetet më të rëndësishme kombëtare të vendit. Shpërfillja e vazhdueshme e qëndrimeve dhe prioriteteve strategjike të aleatit më të afërt të Kosovës bart rrezikun e ndikimit në cilësinë dhe thellësinë e këtij partneriteti me kalimin e kohës", u tha në reagimin e OEAQ-ut më 17 qershor.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk është përfshirë në projektet që zgjerojnë ndikimin energjetik të Shteteve të Bashkuara në rajon. Qeveria në detyrë e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka shprehur më shumë interesim për "gazifikimin e qymyrit"

vendor. "Këtë [gazifikimin e qymyrit] mund ta bëjmë me një kompani amerikane, për shembull", ka deklaruar më herët Kurti.

Gazifikimi i qymyrit nënkupton procesin industrial ku qymyri shndërrohet në gaz të djegshëm, të quajtur gaz sintetik, i cili më pas mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë tha se është shqetësues fakti që të gjitha shtetet e tjera të rajonit kanë shprehur zotim që të bëhen pjesë e infrastrukturës rajonale të LNG-së, "e cila po zhvillohet me mbështetje të fuqishme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës". "Kosova rrezikon të mbetet jashtë një kornize strategjike rajonale që po përcakton gjithnjë e më shumë të ardhmen e sigurisë energjetike dhe zhvillimit ekonomik në Evropën Juglindore", tha OEAQ-u.

Kjo odë tha se Kosova varet për prodhim të energjisë nga kapacitete të vjetruara gjeneruese - duke iu referuar dy termocentraleve të vjetra me qymyr, Kosova A dhe Kosova B ku prodhohet rreth 90 për qind e energjisë - dhe nga importet e mëdha të energjisë. Prandaj, sipas kësaj ode, qasja në LNG-në



amerikane përfaqëson jo vetëm një mundësi energjetike, por edhe "një zgjedhje strategjike". "Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u bënë thirrje institucioneve të Kosovës që të rivlerësojnë me kujdes implikimet afatgjata strategjike, ekonomike dhe gjeopolitike të qëndrimit jashtë nismave rajonale për LNG-në dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për këtë çështje me rëndësi të veçantë", tha OEAQ-u.

Kjo thirrje e OEAQ-ut vjen pasi nga Ambasada Amerikane në Prishtinë vazhdimisht së voni po bënë thirrje për përfshirjen e Kosovës në projektin e LNG-së

amerikane.

E ngarkuara me punë në këtë ambasadë, Anu Prattipati, tha në fillim të qershorit se Kosova nuk po arrin t'i përbushë kërkesat në rritje për furnizim me energji dhe citoi të dhënat e Doganës së Kosovës, se vendi ka shpenzuar 735 milionë euro në importimin e energjisë elektrike nga vendet fqinje në katër vjetët e fundit. Këto të dhëna tregojnë një rritje nga 142 milionë euro në vitin 2024 në 259 milionë euro në vitin 2025. Sipas Prattipatit, në një të ardhme të afërt, teksa çmimi dhe kërkesat për energji vazhdojnë të rriten Kosova, do të varet gjithnjë e më shumë nga fqinjët e saj.

Prattipati, në opinionin e

publikuar në mediet lokale, gjithashtu e citoi të dërguarin e posaçëm të Departamentit Amerikan të Energjisë, Joshua Volz, i cili tha për Radion Evropë e Lirë më 10 maj se "sistemi energjetik në Kosovë ka nevojë urgjente për modernizim dhe paraqet mundësi të shkëlqyeshme për industrinë dhe teknologjinë amerikane", dhe se "Departamenti i Energjisë do të jetë i gatshëm të ndihmojë në lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet industrisë amerikane dhe partnerëve industrialë në Kosovë". "Për të adresuar këto sfida strukturore, Kosova do të duhej t'u bashkohej projekteve amerikane të gazit natyror të planifikuara nëpër Ballkan. Këto projekte mund të sigurojnë burime energjetike amerikane për Kosovën", shkroi Prattipati.

Së voni, disa shtete të Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar marrëveshje me kompani amerikane dhe ShBA-në për ta zgjeruar rrjetin e gazit. Në iniciativa të rëndësishme kanë hyrë: Shqipëria, Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina, përfshirë edhe një projekt të madh për ndërtimin e një tubacioni gazi që synon ta shkëpusë Sarajevën nga furnizimet ruse.

BQK DHE CBUAE NËNSHKRUANJË MEMORANDUM STRATEGJIK PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË MBIKËQYRJE, FINANCA DHE FINTECH

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili dhe Khaled Mohamed Balama, guvernatori i Bankës Qendrore të Emirateve të Bashkuara Arabe (CBUAE), nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MoU), që synon forcimin e marrëdhënieve bilaterale dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës në fushat me interes të përbashkët. Nënshkrimi u zhvillua në selinë e CBUAE-së në Abu Dhabi.

Në kuadër të këtij memorandumi mirëkuptimi, të dyja palët do ta avancojnë koordinimin në fushat mbikëqyrëse dhe rregullative si dhe do të shkëmbejnë ekspertizë lidhur me zhvillimin e teknologjisë financiare, politikën monetare,



makroprudenciale dhe stabilitetin financiar. Memorandumi i mirëkuptimit përfshin gjithashtu një numër fushash prioritare, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorëve financiarë, përfshirjen dhe

edukimin financiar, bankimin me parime islame, mbikëqyrjen bankare, mbikëqyrjen dhe vëzhgimin e sistemeve të pagesave, zbatimin e standardeve ndërkombëtare prudenciale, si dhe parandalimin

e pastrimit të parave dhe luftimit e financimit të terrorizmit (AML/CFT), në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të të dyja palëve.

Duke komentuar nënshkrimin e këtij memorandumi, Khaled Mohamed Balama, guvernatori i CBUAE-së, tha se ky bashkëpunim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës vjen në një kohë të transformimeve të shpejta në sektorin financiar global, të cilat kërkojnë kanale më të fuqishme institucionale të bashkëpunimit ndërmjet bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse. "Përmes këtij memorandumi mirëkuptimi, synojmë të shkëmbejmë njohuri dhe praktika më të mira që rrisin gatishmërinë dhe aftësinë e sektorit financiar për të ecur në

hap me ndryshimet, në mbështetje të vizionit të lidershit tonë dhe interesave të ndërsjella të të dy vendeve", tha ai.

Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, tha se ky memorandum i parë i mirëkuptimit me Bankën Qendrore të Emirateve të Bashkuara Arabe përbën një moment historik për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. "Ai pasqyron përkushtimin tonë për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione partnere me reputacion të lartë, forcimin e kapaciteteve tona institucionale dhe mbështetjen e modernizimit të vazhdueshëm të sektorit financiar të Kosovës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë", u shpreh Ahmeti.

Statistikat për thëngjillin, 20 për qind më shumë prodhuar në prill të 2026-s se në të njëjtin muaj në vitin paraprak

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikave të energjisë për muajin prill 2026 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të

tjerë. Referuar këtyre statistikave del që është prodhuar më shumë thëngjill në prill 2026 sesa në prill 2025. "Prodhimi i thëngjillit për muajin prill 2026 ishte 826 993 mijë ton, që paraqet një rritje prej 20,70 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar", bëhet e ditur nga të dhënat e ASK-së.

Agjencia më tej ka njoftuar edhe lidhur me konsumin e energjisë elektrike.

Sipas ASK-së, konsumi i energjisë elektrike ishte 460 66 GWh ose 5,58 % më i madh, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, kurse energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 567 64 GWh ose (-0.07 %) më e ulët

krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 16,36 %.

Importi i energjisë elektrike në prill të vitit 2026 ishte 335,29 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtin periudhë ishte 203, 27



GWh (këtu është e përfshirë edhe sasia e transmisionit).

'APOKALIPSI BËRTHAMOR' NGA STALINGRADI TE KUBA, 17 VITE QË NDRYSHUAN BOTËN

Në vitin 1945, Bashkimi Sovjetik ishte aleat i Perëndimit në luftën kundër Gjermanisë naziste. Por vetëm 17 vjet më vonë ndodhi apokalipsi bërthamor, të dyja palët qëndronin përballë njëra-tjetrës, të gatshme të zhduknin botën në një apokalips bërthamor. Kjo është historia se si një aleancë e lindur nga nevoja u shndërrua në rivalitetin më të rrezikshëm të historisë moderne.



NGA DAVID REYNOLDS

Ne e quajmë Lufta e Ftohtë, por në tetor 1962 bota dukej sikur ishte gati të digjej. Vendimi sovjetik për të vendosur raketa bërthamore në Kubë shkaktoi një krizë me Shtetet e Bashkuara që kërcënoi të përfundonte në një holokaust global.

Si ishte arritur deri këtu?

Dy dekada më parë, SHBA dhe BRSS kishin qenë aleate në luftën kundër Gjermanisë naziste. Në mars 1943, revista "Life" i përshkruante rusët si "një popull i mrekullueshëm" që "duken si amerikanë, vishen si amerikanë dhe mendojnë si amerikanë". Sa për NKVD-në (policinë sekrete famëkeqe të Josif Stalinit), "Life" deklaronte se ajo ishte "e ngjashme me FBI-në". Në realitet, aleanca e kohës së

luftës kishte qenë një martesë interesante. "Lidhja kryesore e fitimtarëve", pranonte Winston Churchill, kishte qenë "urrejtja e tyre e përbashkët" ndaj Rajhut të Tretë të Hitlerit, por kjo nuk mjaftonte më për t'i mbajtur bashkë pas vitit 1945.

Tre çështje themelore qëndronin në zemër të Luftës së Ftohtë: ideologjia, gjeopolitika dhe armët bërthamore.

Ideologjikisht, mantra amerikane ishte "liria": sipërmarrja e lirë, qeveria e kufizuar dhe demokracia lokale. Socializmi dhe komunizmi mbeteshin lëvizje të vogla në SHBA dhe stigmatizoheshin lehtësisht si "jo-amerikane".

Në BRSS, ideologjia marksiste-leniniste parashikonte krizën e afërt të kapitalizmit imperialist dhe ardhjen e diktaturës së proletariatit, ku Partia Komuniste Sovjetike do të ishte pararojë. Edhe pse deri në vitet 1940 Stalini kishte zbutur retorikën e

revolucionit botëror, ai mbetej i etur për të përshpejtuar procesin e ndryshimit historik. Kaosi i shkaktuar nga Lufta e Dytë Botërore i ofronte shumë mundësi.

Konflikti ndryshoi gjithashtu pozicionin gjeopolitik të të dy vendeve, duke i tërhequr në boshllëqet e pushtetit të krijuara nga shkatërrimi i fuqive të Boshtit. Këto zona u shndërruan në pikat e nxehta të Luftës së Ftohtë, mbi të gjitha në Gjermani, Kinë dhe Kore.

SHBA dhe BRSS pushtuan Gjermaninë për të mposhtur Hitlerin dhe më pas qëndruan për të formësuar paqen. Sovjetikët kishin humbur rreth 27 milionë njerëz gjatë viteve 1941-1945 dhe ishin të vendosur të pengonin rikthimin e fuqisë ushtarake gjermane. Por Amerika dhe Britania kishin po aq interes që Gjermania të ringrihej ekonomikisht.

Në vitin 1948, SHBA, Britania dhe

Franca thyen bllokimin diplomatik dhe nisën krijimin e një shteti të Gjermanisë Perëndimore nga zonat e tyre të pushtimit. Ato prezantuan gjithashtu një monedhë të re, Deutsche Mark, e cila pothuajse brenda natës riktheu mallrat në dyqane.

Stalini reagoi duke bllokuar Berlinin Perëndimor, të cilin aleatët mund ta furnizonin vetëm përmes Gjermanisë Lindore të kontrolluar nga sovjetikët.

Presidenti Harry Truman nuk kishte asnjë dyshim se qëndrimi në Berlin ishte bërë "simbol i objektivave amerikane" në Europë. Kështu, në bashkëpunim me RAF-in britanik, Forcat Ajrore Amerikane organizuan një urë ajrore të pandërprerë me ushqime dhe karburant për qytetin e rrethuar gjatë dimrit 1948-1949. Në kulmin e saj, Berlini përpunonte më shumë trafik ajror sesa Nju Jorku.

Kjo urë ajrore jo vetëm që theu bllokadën e Stalinit, por ndryshoi edhe qëndrimin e gjermano-perëndimorëve ndaj amerikanëve dhe britanikëve. Ish-armiqët po bëheshin aleatë, ndërsa aleatët e kohës së luftës po shndërroheshin në kundërshtarë.

Në prill 1949, SHBA firmosi Traktatin e Atlantikut të Veriut (NATO) me Kanadanë dhe dhjetë shtete europiane, të udhëhequra nga Britania dhe Franca. Bastit të Stalinit në Berlin iu kthye efekti mbrapsht, duke e shtyrë Perëndimin drejt një aleance transatlantike të paprecedentë.

Megjithatë, "korrelacioni global i forcave", siç e quanin sovjetikët, ndryshoi sërish vitin pasues. Në tetor 1949, pas tre dekadash lufte civile, Mao Ce Duni dhe komunistët fituan plotësisht në Kinë. Vendi më i populluar në botë ishte bërë "i kuq", duke shkaktuar alarm dhe akuzat të ndërsjella në Amerikë.

“Apokalipsi bërthamor”, sulme dhe kundërsulme

Një tronditje edhe më e madhe erdhi në Kore. Në vitin 1945, forcat japoneze u dorëzuan para sovjetikëve në veri dhe amerikanëve në jug. Ashtu si në Gjermani, asnjëra superfuqi nuk dëshironte ndarjen e përhershme të vendit. Por klientët e tyre ishin të vendosur ta bashkonin atë me forcë.

Në qershor 1950, Stalini i dha dritën jeshile udhëheqësit të Koresë së Veriut, Kim Il-sung, për të sulmuar jugun, duke menduar se Perëndimi nuk do të reagoonte. Ky ishte gabimi i dytë i madh strategjik i Stalinit brenda vetëm dy vitesh.

Ashtu si Berlini, Koreja ishte për Trumanin një simbol jetik i vullnetit dhe fuqisë amerikane. Ai besonte se “komunizmi po vepronte në Kore ashtu siç kishin vepruar Hitleri, Musolini dhe japonezët 10, 15 apo 20 vjet më parë”.

Mësimet e politikës së qetësimit dukeshin të qarta: “Nëse kjo lejohet të kalonte pa kundërpërgjigje, do të nënkuptonte një Luftë të Tretë Botërore.”

Truman angazhoi forcat amerikane në Kore, duke siguruar edhe mbështetjen e aleatëve kryesorë, përfshirë Britaninë.

Lufta Koreane u kthye në një konflikt me luhatje të mëdha. Fillimisht koreano-veriorët depërtuan thellë në jug, por kundërsulmet amerikane i shtynë pothuajse deri në kufirin kinez. Kjo provokoi ndërhyrjen e

Kinës në luftë.

Luftimet u stabilizuan përfundimisht rreth paralelit të 38-të, i cili u bë baza e armëpushimit të vitit 1953. Ky armëpushim mbetet në fuqi edhe sot, në një vend që vazhdon të jetë i ndarë.

Stalini përfitoi nga shumë mundësi që u krijuan nga kaosi i Luftës së Dytë Botërore, por po aq shpesh bëri edhe gabime të mëdha strategjike.

Koreja ishte vendi ku Lufta e Ftohtë u bë e nxehtë: amerikanët humbën 33,000 ushtarë; kinezët ndoshta gjysmë milioni, përfshirë një nga djemtë e Maos; ndërsa numri i përgjithshëm i viktimave koreane mund të ketë arritur në 2.5 milionë, rreth një e dhjeta e popullsisë.

Gjatë viteve 1950, boshllëqe të tjera pushteti u hapën ndërsa dekolonizimi u përshpejtua. Megjithëse dorëzimi i Japonisë në vitin 1945 u lejoi europianëve të rimerrnin shumicën e zotërimeve të tyre aziatike, ditët e perandorive tashmë ishin të numëruara. Britanikët i dhanë pavarësinë Indisë dhe Birmanisë dy vjet më vonë; holandezët hoqën dorë nga Inditë Lindore (Indonezia); ndërsa Franca dështoi në përpjekjen e saj të viteve 1946–1954 për të mbajtur Indokinën.

Të pavullnetshëm për të parë të gjithë rajonin të bëhej komunist, presidentë të njëpasnjëshëm amerikanë u zhytën në luftën e Vietnamit, një konflikt që përfundimisht u shndërrua në poshtërimin më të madh të Amerikës gjatë gjithë Luftës së Ftohtë.

Deri atëherë, SHBA kishte qenë kampione e lirisë kundër fuqive

perandorake. Por në vitet 1950, Uashingtoni u përball me një dilemë: cili ishte më i papranueshëm dhe më i rrezikshëm: kolonializmi apo komunizmi?

Nga frika e zgjerimit të së majtës, Uashingtoni arriti në përfundimin se ishte më mirë të mbështeste regjimet koloniale dhe klientët e rinj postkolonialë. Kjo çoi në ndërhyrje amerikane në vende si Irani në vitin 1953 dhe Guatemala në vitin 1954.

Përrshkallëzimi atomik

Ishte gjithashtu gjatë viteve 1950 që gara e armëve bërthamore – shenja e tretë dalluese e Luftës së Ftohtë – u bë vërtet ekzistenciale, me veprimin dhe kundërveprimin në një dinamikë të përhershme. Në vitin 1945, shpërthimi i dy bombave atomike amerikane mbi Japoninë kishte ndihmuar në përfundimin e luftës në Azi, por Stalini e bëri menjëherë bombën atomike prioritetin e tij kryesor; në gusht 1949, BRSS testoi me sukses pajisjen e vet të parë atomike. Monopoli i tyre atomik mori fund dhe amerikanët nisën zhvillimin e bombës me hidrogjen në vitin 1952 – sovjetikët i barazuan një vit më vonë, në 1953.

Gara më pas u zhvendos te përmirësimi i “sistemeve të shpërndarjes”, nga epoka e fuqisë ajrore në epokën e raketave. Këtë herë sovjetikët i paraprinë amerikanëve. Lëshimi i satelitit artificial Sputnik në nëntor 1957 ishte njëkohësisht një poshtërim teknologjik për SHBA-në dhe një shenjë se BRSS zotëronte një

teknologji mjaftueshëm të fuqishme për të lëshuar një raketë bërthamore deri në Amerikë. Administrata e Eisenhower-it përshpejtoi me nxitim programin e vet të raketave dhe zbatoi një plan të madh të mbrojtjes civile.

Ideologjia, gjeopolitika dhe bomba u shkrinë së bashku në krizën mbi Kubën. Fidel Castro kishte marrë pushtetin në ishull në vitin 1959, duke rrëzuar një regjim të korruptuar që ishte, në emër, një koloni ekonomike amerikane. Megjithëse Castro nuk ishte fillimisht marksist, reagimi i Uashingtonit ndaj reformave të tij e shtyu atë në krahët e Moskës. John F. Kennedy trashëgoi një plan gjysmak, të përgatitur të CIA-s për të rrëzuar Castron, duke përdorur emigrantë kubanë në SHBA për të shmangur implikimin e drejtpërdrejtë të Shtëpisë së Bardhë. Por operacioni i Gjirit të Derrave në prill 1961 rezultoi një fiasco – duke lënë vëllain energjik të presidentit, Bobby-n, të zemëruar se JFK tani do të konsiderohej nga rusët si “një tigrë prej letre”.

Përballja u thellua kur Nikita Hrushovi, udhëheqësi i zjarrtë sovjetik, fitoi epërsi ndaj Kennedyt në një samit të ashpër në Vjenë, në qershor 1961. I inkurajuar nga sukcesi, ai vendosi raketa bërthamore me rreze të mesme veprimi në Kubë, vetëm 90 milje larg brigjeve të Floridës. Ndryshe nga Stalini në Berlin në vitin 1948, Kennedy ishte në gjendje të vendoste një bllokadë ndaj Kubës, duke kontrolluar hapësirën ajrore dhe ujërat përreth dhe, mbi të gjitha, duke gëzuar epërsi të madhe në

arsenale bërthamore në rast të një lufte të përgjithshme. Kështu, Hrushovi vendosi t'i tërhiqte raketat e tij nga Kuba. Por ishte një çështje që kishte kaluar shumë afër katastrofës. Siç tha sekretari i Shtetit Dean Rusk, të dy superfuqitë kishin qenë “sy më sy” dhe në fund ishin sovjetikët ata që “u tërhoqën”.

Më 26 qershor 1963, Kennedy, tashmë i sigurt në presidencën e tij, foli në Berlinin Perëndimor. Dy vera më parë, sovjetikët dhe aleatët e tyre të Gjermanisë Lindore kishin ngritur një mur për të ndalur rrjedhën e gjermanolindorëve – kryesisht të rinj, të aftë dhe të arsimuar – që largoheshin në kërkim të lirisë dhe prosperitetit. Muri ndaloi rrjedhjen e trurit, por u shndërrua në një autogol propagandistik.

Duke qëndruar para një turme entuziaste jashtë bashkisë së Berlinit Perëndimor, Kennedy pranoi se “liria ka shumë vështirësi dhe demokracia nuk është e përsosur”. Por ai shtoi: “Ne nuk kemi pasur kurrë nevojë të ndërtojmë një mur për t'i mbajtur njerëzit tanë brenda.”

Për ata që pretendonin se nuk e kuptonin se çfarë ishte në lojë mes botës së lirë dhe asaj komuniste, presidenti dha këtë sfidë të thjeshtë: “Le të vijnë në Berlin.”

Siç e dimë sot, Lufta e Ftohtë kishte ende një çerek shekulli për të vazhduar, me shumë kthesa dhe peripeci. Por ajo ditë vere në Berlin do të përcaktonte pjesën tjetër të kësaj përbaljeje. / bota.al





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Mbappe shkruan historinë, bëhet golashënuesi më i mirë i Francës

NEW JERSEY, 17 QERSHOR - Kylian Mbappe ka hyrë në historinë e futbollit francez. Sulmuesi i Francës ka realizuar dy gola në fitoren 3-1 ndaj Senegalit në ndeshjen hapëse të Kupës së

Botës 2026, duke u bërë golashënuesi më i mirë në historinë e Kombëtares franceze. Me këta dy gola, Mbappe ka arritur në kuotën e 58 golave në vetëm 99 paraqitje me fanellën e

Francës, duke lënë pas Olivier Giroud, i cili e kishte mbajtur rekordin me 57 gola në 137 ndeshje. Në moshën 27-vjeçare, kapiteni i Francës vazhdon të thyjë rekorde dhe tashmë synon

edhe një tjetër arritje historike: rekordin absolut të golave në historinë e Kupës së Botës, ku i duhen vetëm dy gola për të barazuar me Miroslav Klosen dhe Lionel Messin.



SPARTA KËRKON 10 MILIONË EURO PËR RRAHMANIN

PRAGË, 17 QERSHOR - Skuadra e Serisë A Venezia ka bërë një ofertë zyrtare prej 6 milionë eurove për sulmuesin e Sparta Pragës, Albion Rrahmani. Ylli i Kosovës është dëshira e madhe e klubit të sapopromovuar në Itali të cilët duan disa përf forcime për sezonin e ardhshëm. Siç raporton "Triventgoal",

Venezia ka dërguar një ofertë zyrtare prej 6 milionë eurosh, por që kjo nuk e ka kënaqur klubin çek, i cili e vlerëson lojtarin rreth 10 milionë euro. "Në orët e fundit Venezia ka dërguar te Sparta Praga një ofertë prej 6 milionë eurove. Aktualisht klubi çek e ka refuzuar dhe po kërkon 10 milionë euro", ka raportuar



"Triventgoal".

Përndryshe është ende e paqartë nëse marrëveshja do të finalizohet shkaku i çmimit të lartë që po kërkon Sparta Praga. Rrahmani ndërkohë ka kaluar një sezon fantastik sezonin e kaluar, ku shënoi 16 gola e dhuroi katër asistime në të gjitha garat, në 49 paraqitje.

SHAQIRI PARALAJMËRON LARGIMIN NGA BASELI



BASEL, 17 QERSHOR - Xherdan Shaqiri ka ngritur pikëpyetje mbi të ardhmen e tij te Baseli, duke pranuar se një largim gjatë këtij afati kalimtar mbetet një mundësi reale. Në një konferencë për medie në fillim të përgatitjeve për sezonin e ri, mesfushori ofensiv ka deklaruar se nuk mund të garantojë se do të vazhdojë të jetë pjesë e klubit zviceran edhe pas kësaj vere. "Është e mundur të largohem nga Baseli gjatë këtij afati kalimtar", ka thënë Shaqiri para gazetarëve. Megjithatë, 34-vjeçari ka theksuar se

largimi nuk është objektivi i tij kryesor dhe se ndihet i lumtur në klubin ku ka ende një vit kontratë. "Në futboll, ashtu si në jetë, gjithçka është e mundur. Nuk ka kurrë siguri. Do të shoh me kujdes se çfarë po ndodh te Baseli. Do t'i kushtoj vëmendje mënyrës se si po ndërtohet ekipi. Dua një skuadër të mirë për ta udhëhequr", ka thënë Shaqiri. Komentet e tij konsiderohen mesazh i drejtpërdrejtë për drejtuesit e klubit, pas një sezoni zhgënjyes krahasuar me vitin e kaluar, kur Baseli arriti të fitonte dy trofe. "Po

përpiqem të arrij rezultatet më të mira të mundshme. Edhe unë duhet të performoj, por për këtë më duhen edhe bashkëlojtarët. Jam shumë i relaksuar për momentin. Jam shumë i lumtur te Baseli dhe kam ende një vit kontratë këtu", ka thënë Shaqiri. Deklaratat e Shaqirit pritet ta shtojnë interesimin rreth të ardhmes së tij, ndërsa mbetet për t'u parë nëse drejtuesit e Baselit do t'i përgjigjen kërkesës së tij për një skuadër më konkurruese apo nëse veterani do të kërkojë një aventurë të re.


MESSI BARAZON REKORDIN HISTORIK NË KUPËN E BOTËS

KANSAS CITY, 17 QERSHOR - Argjentina e ka nisur mbrojtjen e titullit të kampionit të botës me një fitore bindëse 3-0 ndaj Algjerisë në Kansas City, ndërsa Lionel Messi ka shkruar edhe një herë historinë me një paraqitje të jashtëzakonshme. Ylli 38-vjeçar ka realizuar tre gola, duke regjistruar "hat-trick"-un e tij të parë në një Kupë Bote dhe duke barazuar rekordin e legjendës gjermane, Miroslav

Klose me 16 gola në historinë e turneut. Fillimi i ndeshjes ishte i vështirë për Argjentinën. Të dyja skuadrat kanë realizuar gola në minutat e para, por si goli i Lionel Messit ashtu edhe ai i Fares Chaibi për Algjerinë janë anuluar për pozicion jashtë loje pas ndërhyrjes së VAR-it. Megjithatë, në minutën e 20 ka ardhur momenti magjik i Messit. Pas një pasimi perfekt nga Rodrigo De Paul, kapiteni argjentinës ka depërtuar mes

mbrojtësve dhe ka goditur saktë në këndin e sipërm të portës për t'i dhënë epërsinë skuadrës së Lionel Scalonit. Messi ka vazhduar spektaklin edhe në pjesën e dytë. Fillimisht ai ka përfutur nga një top i kthyer nga portieri pas goditjes së Alexis Mac Allister për ta realizuar golin e dytë, ndërsa më pas ka kompletuar "hat-trick"-un pas asistimit të Nicolas Gonzalez. Me këtë paraqitje historike, Messi ka arritur në kuotën e

911 golave në karrierë për klub dhe kombëtare. Ai tashmë ndan vendin e parë në listën e golashënuesve më të mirë në historinë e Kupës së Botës me Miroslav Klosen dhe i nevojitet vetëm edhe një gol për t'u bërë golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve në këtë kompeticion. Përveç kësaj, ai është vetëm një asist larg thyerjes së rekordit të Diego Maradonës për numrin më të madh të asistimeve në historinë e Kupës së Botës.



Bernardo Silva i bashkohet Real Madridit

MADRID, 17 QERSHOR - Real Madridi ka njoftuar zyrtarisht nënshkrimin e një ylli të ri të mesfushës. Real Madridi ka

konfirmuar mbërritjen e mesfushorit 31-vjeçar portugez, Bernardo Silva. Ai i është bashkuar "Los Blancos" si lojtar i lirë,

duke nënshkruar një kontratë dyvjeçare që do ta mbajë atë në klub deri në verën e vitit 2028. Gjatë sezonit 2025/26, Silva ka

luajtur 53 ndeshje për Manchester Cityn në Angli, ku ka shënuar tri gola dhe ka bërë pesë asistime.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Assisto” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812036582 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Assisto” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812036582 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Assisto” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812036582 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Neuron App” L.L.C. pronar Hakan Shehu me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812197491 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Neuron App” D.O.O. Hakan Shehu Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812197491 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Neuron App” L.L.C. with owner Hakan Shehu with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812197491 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Diora Butique” SH.P.K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812106400 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Diora Butique” D.O.O. Lipjan donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812106400 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Diora Butique” L.L.C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 812106400 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “AFK Enterprises” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812289157 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “AFK Enterprises” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812289157 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “AFK Enterprises” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812289157 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite


RESTAURANT



SWISS


TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553



Lume's Details

Estetik & Depilim




044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details


lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Praude-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
 Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
 Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets



Ftesë për Ankand Publik

Datë 17.06.2026 **Referenca: AAPSK 006/2026**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf II ngjyre e kuqe- për skrap.	1 copë/ për skrap	160.10€		
3	Kamionetë Daimler Benz 312D, ngjyrë e verdhë, viti i prodhimit 1997, dizel -me targa vendore	1 copë	2,850.00€		
3	VW Golf II ,ngjyre vishnje viti i prodhimit 1987, dizel-targa vendore	1 copë	300.00€		
4	VW Golf II 19 E, ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 1986, dizel.-per pjesë-skrap	1 copë/ për pjesë-skrap	300.00€		
5	Motocikletë Kawasaki Z300, ngjyrë hiri, viti i prodhimit 2016, benzin sipas tregut të huaja	1 copë-	1,700.00€		
6	Motocikletë Catalyzen Flippen, ngjyrë e kaltër, benzin -për pjesë	1 copë/ për pjesë-	200.00€		
7	VW Touran 1T, ngjyrë e bardhë viti i prodhimit 2003, dizel-targa vendore	1 copë	3,700.00€		
8	Xhip Audi Q5, ngjyrë e hirit, viti i prodhimit 2021, dizel/hibrid/elektrik, automatik- targa vendore	1 copë	40,000.00€		
9	Xhip Mercedes Benz, modeli GLC 220D 4 MATIC, ngjyrë e kuqe viti i prodhimit 2024, dizel/hibrid/elektrik, automatik -targa vendore	1 copë	60,000.00€		
10	VW CD Golf, ngjyrë e bardhë viti i prodhimit 2022, dizel, automatik -targa vendore	1 copë	23,000.00€		
11	Furgon VW 70XOA,ngjyrë e kaltër, viti i prodhimit 1993, dizel- për pjesë	1 copë/ për pjesë-	300.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri me **23.06.2026 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahitri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.**

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **23.06.2026, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë,**

Pasuritë e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapks.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkrubet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valbone Çelaj shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m. "Dr. Xheladin Deda".

- D.P.Z. Mobileria "Preciz" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik: 810564460

- Amela Hoti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Musa Hoti".

- Artan Bashkim Lushaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u "Zenun Çoçaj" Gjonaj Prizren.

- Albert Batalli B.I. D.P.Z. "Aldi" shpall të humbur numrin unik identifikues: 810226284.

- Gjon Marashi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Luigj Gurakuqi" Korenic KK Gjakovë, nga kl. 1-9.

- Gjylsha Hodaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zenun Çoçaj" në Gjonaj.

- Gent Rrahmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Hekuran Hajdari shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u "Dëshmorët e Dushkajës" Bardhaniq Gjakovë.

- Hekuran Hajdari shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 9 sh.m.u. "Dëshmorët e Kombit" Jabllanicë KK Gjakovë.

- Pashk Luli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Dëshmorët Lleshi" Doblbare KK Gjakovë nga kl. 6-9.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjurar nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



